

## KOMUNA E MAMUSHËS

### NJOFTIMI PËR KONKURSION E PROJEKTIMIT

Sipas Nenit 75 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit:

Nr. i Prokurimit	626-24-6359-2-2-3
Nr. i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



#### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

##### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar: <b>KOMUNA E MAMUSHËS</b>		
Adresa Postare: <b>Rruga "Sahat Kulesi" nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës</b>		
Qyteti: <b>Mamushë</b>	Kodi postar: <b>20540</b>	Vendi: <b>Kosovë</b>
Personi kontaktues: <b>Gazmend Gashi</b>	Telefoni: <b>03820045211</b>	
Email: <b>mamusha.prokurimi@rks-gov.net</b>	Faksi: /	
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): <b><a href="http://kk.rks-gov.net/mamushe/">http://kk.rks-gov.net/mamushe/</a></b>		

Konkursi përfshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Konkursi udhëhiqet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Po



Jo



*Nëse po*, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese ose referoju një Aneksi.

#### NENI II: LËNDA E KONKURSIONIT TË PROJEKTIMIT/PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

##### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i dhënë për konkursin e projektimit/projektin nga autoriteti kontraktues: Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal me VSM, hartimi i hartave zonale me VSM dhe hartimi i PLVM**

### II.1.2) Përshkrimi i shkurtër për konkursin e projektimit/projektin

Lënda e këtij konkursi projektimi ka të bëjë me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal me VSM (Vlerësim Strategjik Mjedisor), hartimin e hartave zonale me VSM dhe hartimin e PLVM (Planit Lokal për Veprim në Mjedis). Kontrata për këtë konkurs projektimi është kontratë afatgjate e cila do të realizohet brenda 24 muajve nga data e nënshkrimit të sajë.

### II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP)

73200000-4

## NENI III: INFORMACIONE LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET PËR PJESMARRJE

#### III.1.1)

##### Kërkesat e përshtatshmërisë:

1) Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik i plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s

2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.

3) Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.

4) Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj nuk duhet të jetë i dënuar nga ndonjë gjykatë kompetente për kryerjen e ndonjë vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos dhe avantazheve gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara.

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1) Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 të dosjes së tenderit.

2) Një vërtetim apo certifikatë origjinale (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

4) Vërtetim nga sistemi qëndror i evidencës penale ose organi kompetent në vendin e themelimit të Operatorit Ekonomik. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.

#### III.1.2)

##### Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e themelimit të O.E.

2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së

##### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.

2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent në vendin e

<p>3. Operatorë ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK</p>	<p>themelimit të O.E. 3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal(nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit).</p>
<p><b>III.1.3)</b> <b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b> 1. Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar së paku 110,000.00 € në tri vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.</p>
<p><b>III.1.4)</b> <b>Kapaciteti teknik dhe professional:</b> 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte ose plane të natyrës së ngjajshme në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 80,000.00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të minimum 60% të vlerës së kërkuar kontrata të natyrës së ngjajshme. 2. O.E. duhet të caktoj me vendim ose të autorizoj menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë Inxhinier i diplomuar ose master i arkitekturës – drejtimi urbanist me së paku 7 (shtatë) vite përvojë pune pas diplomimit. 3. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka staf profesional për kryerjen e projektit së paku 3.1) Një (1) inxhinier të diplomuar ose master i arkitekturës – drejtimi urbanist me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. 3.2)Një (1) inxhinier të diplomuar ose master i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik me së paku shtatë (7) vite përvojë pune pas diplomimit. 3.3) Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me së paku shtatë (7) vite përvojë pune pas diplomimit 3.4) Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i elektroteknikës me së paku shtatë (7) vite përvojë pune pas diplomimit. 3.5) Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i mjedisit me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. 3.6) Një (1) person i certifikuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. 3.7) Një (1) bachelor apo master i diplomuar i Bujqësisë me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit 3.8) Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit ose gjeodet (shkolla e lartë), ose bachelor i</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Lista e kontratave të realizuara për projekte ose plane të natyrës së ngjajshme, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të projekteve ose planeve. 2. Autorizimi ose vendimi për caktimin e menaxherit të projektit (Original ose Kopje e noterizuar) -Diploma e inxhinierit (kopje e noterizuar. Diploma jashtë shtetit duhet të jetë e nostrifikuar) -Cv-në e inxhinierit të nënshkruar nga inxhinieri (original ose kopje te noterizuar) 3. Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a (original e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë)</p>

diplomuar i gjeodezisë me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit.  
**4. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 - Certifikimi i sistemit për Menagjimin e Cilesisë (në fushën e Planifikimit)**

**4. Kopja e certifikatës ISO e cila dëshmon se Operatori ekonomik është i pajisur me certifikatë valide.**

**III.1.5) A është rezervuar pjesëmarrja për profesionin e caktuar:**

Po  Jo

*Nëse po, tregoni profesionin*

**III.1.6) Vendi ku do të realizohet projekti:**

**Projekti do të realizohet në zyrat e Operatorit Ekonomik fitues dhe në Mamushë me ç'rast do të dorëzohen projektet finale sipas kërkesave të dosjes së tenderit.**

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I KONKURSIT

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

E hapur

E kufizuar

**IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedura e kufizuar)**

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar projektin. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të merren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

### IV.2) KRITERET QË DO TË APLIKOHEN NË VLERSIMIN E PROJEKTEVE

	Nën-kriteret	Pesha në %
	<b>1. Koncepti i Zonimit</b> Koncepti i zonimit duhet të përfshijë propozimin për konceptin e trajtimit të përgjithshëm të Zonave gjatë përgatitjes së Hartës Zonale, si dhe trajtimet e veçanta në disa Zona të trajtuara me Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës, klasifikimin, përgatitjen hapësinore dhe kushtet ndërtimore – 35 pikë	<b>1. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Konceptin e Zonimit sipas specifikave teknike.</b>
	<b>2. Metodologjinë e përgatitjes, strukturimit dhe plotësimit në fushat ku ka mungesa të informatave dhe të dhënave, hartave nga komuna të gjeo-databazës</b> Përshkrimi i mënyrës së përgatitjes, strukturimit dhe plotësimit të informatave, të dhënave, hartave në fushat ku këto ose janë të pjesshme ose mungojnë fare nga burimet komunale si të dhëna në GIS databazën, duke përcaktuar llojin e informatave, atributet, simbologjinë, formatin dhe formatin e hartave që do të ofrohen për Komunën, mënyrën e plotësimit të informatave dhe burimet që shfrytëzohen për kompletimin e informatave që mungojnë – 20 pikë	<b>2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Metodologjinë e përgatitjes, strukturimit dhe plotësimit në fushat ku ka mungesa të informatave dhe të dhënave, hartave nga komuna të gjeo-databazës</b>
	<b>3. Metodologjia e punës</b> Përcaktimi dhe përshkrimi i shkurtër i hapave kyç të cilat propozohen të ndërmerren gjatë procesit të përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës,	<b>3. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Metodologjinë e punës Përcaktimit dhe</b>

	duke përfshirë obligimet ligjore dhe aktivitete shtesë të cilat do të kontribuojnë në krijimin e një dokumenti gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Metodologjia e punës duhet të përshkruaj edhe burimet e të dhënave të cilat do të shfrytëzohen gjatë përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës – 15 pikë	përshkrimin e shkurtër i hapave kyç të cilat propozohen të ndërmerren gjatë procesit të përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës, duke përfshirë obligimet ligjore dhe aktivitete shtesë të cilat do të kontribuojnë në krijimin e një dokumenti gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.
	4. Metodologjia e përfshirjes së pjesëmarrësve Duke e kuptuar si obligim ligjor dhe funksional pjesëmarrjen në procesin e hartimit të hartës Zonale ju duhet të përshkruani edhe metodologjinë e përfshirjes së qytetarëve dhe akterëve tjerë, duhet të përshkruani identifikimin, kategorizimin e pjesëmarrësve, mënyrën e njoftimit, informimit, takimeve dhe përfshirjes së qytetarëve dhe akterëve tjerë në çdo fazë të procesit të përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës – 10 pikë	4. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Metodologjinë e përfshirjes së pjesëmarrësve.
	5. Përkrahja me konsulencë në hartimin e Planit Zhvillimor komunal dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor të PZHK-së Pasi që komuna e Mamushës është në procesin e hartimit edhe të Planin Zhvillimor Komunal, Operatori ekonomik duhet të ketë kapacitete të na përkrah edhe në përgatitjen e këtyre dokumenteve, dhe në këtë drejtim duhet të përshkruaj metodologjinë e punës edhe për përkrahjen e Planit Zhvillimor Komunal. Përcaktimi dhe përshkrimi i hapave kyç të cilat propozohen të ndërmerren gjatë procesit të përgatitjes së Planit Zhvillimor të Komunës, duke përfshirë obligimet ligjore dhe aktivitete shtesë të cilat do të kontribuojnë në krijimin e një dokumenti gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Metodologjia e punës duhet të përshkruaj edhe burimet e të dhënave të cilat do të shfrytëzohen gjatë përgatitjes së Planit Zhvillimor Komunal, si dhe angazhimin e operatorit në proces – 10 pikë	5. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin metodologjinë e punës për përkrahjen e Planit Zhvillimor Komunal
	6. Përkrahje me konsulencë në hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis – Kërkohet nga operatori ekonomik që të paraqesë konceptin dhe metodologjinë e vet për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis të Komunës së Mamushës. – 10 pikë	6. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin konceptin dhe metodologjinë e vet për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis të Komunës së Mamushës

### IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

#### IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njejtë

Po  Jo

*Nëse po,*

Njoftimi paraprak: \_\_\_\_\_ i

Publikimet e tjera (nëse aplikohen)

i

i

#### IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së konkursit / dokumentet e para-kualifikimit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për *dosje të konkursit / dokumentet e para-kualifikimit*

Data **12.08.2024** koha **14:00**

**Dokumentet me pagesë:**

Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po</i> , çmimi EUR Kushtet dhe mënyra e pagesës:
<b>IV.3.3) Afati kohor për pranimin e projekteve / aplikacioneve:</b> <i>Data</i> <b>12.08.2024</b> <i>koha</i> <b>14:00:00</b> <i>vendi</i> <b>Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17</b>
<b>IV.3.4)</b> Projektet apo kërkesat për pjesëmarrje mund të merren në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

#### **IV.4) SHPËRBLIMET**

<b>IV.4.1) Çmimi/çmimet do të open:</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po</i> , numri dhe vlera e çmimeve të cilat do të shpërblehen:
<b>IV.4.2) Detajat e pagesës/vlerat e çmimeve që do të jepen:</b>
<b>IV.4.3) Kontratat përcjellëse</b> Cilado kontratë e shërbimeve e cila shoqëron konkursin do të jepet fituesit apo njërit prej fituesve të konkursit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
<b>IV.4.4) Vendimi i jurisë është detyrues për autoritetin kontraktues:</b> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>

#### **NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

##### **V.1) ANKESAT**

<b>Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi.</b>
--

##### **V.2) INFORMACIONET SHITESË**

<i>Shto informacione tjera:</i>
---------------------------------